



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 47 20 – 26 Nëntor 2023

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, HAS, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 0 NJVKSH ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 47

	JAVA 47
DIARRE PA GJAK	1.064
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.257
INF. RESP. TE POSHTËME	3.213
RASH ME TEMPERATURË	37
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	418
% e Njësive Raportuese	95% (418/446)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Fier - 1 rast

Gramsh – 1 rast


Kruje – 1 rast

Pogradec – 2 raste


Tirane – 32 raste

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet e qëndrueshme në javën 47 krahasuar me javën paraardhëse, java 46.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve



Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rënie në javën 47 krahasuar me javën paraardhëse, java 46.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 40 - 47 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.




Në javën 47 të vitit 2023 vërehet prirje e qëndrueshme e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 46 dhe 47 / 2023. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 40 - 47 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.



Në javën 47 të vitit 2023 vërehet prirje në rënie e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 46 dhe 47 / 2023. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje ndërkombëtare

1. *Survejanca sezonale e virusit të Nilit Perëndimor– 2023*

- Që nga përditësimi i fundit dhe që nga data 22 nëntor 2023, katër raste njerëzore të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor (WNV) janë raportuar nga vendet e BE/EEA dhe asnjë rast nuk është raportuar nga asnjë vend fqinj me BE-në.
- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit 2023, 698 raste njerëzore të infeksionit WNV janë raportuar nga vendet e BE/EEA dhe 93 nga vendet fqinje të BE-së.
- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit të WNV 2023, dhe që nga 22 nëntori 2023, vendet e BE/ZEE kanë raportuar 146 shpërthime në mesin e ekuideve dhe 246 shpërthime midis shpendëve.

2. *Kolera –Monitorimi i shpërthimeve globale*

- Që nga 26 shtatori 2023 dhe deri më 31 tetor 2023, janë raportuar 53 327 raste të reja të kolerës, duke përfshirë 482 vdekje të reja në mbarë botën.
- Raste të reja janë raportuar nga Afganistani, Burundi, Kameruni, Republika Demokratike e Kongos, Etiopia, Haiti, Kenia, Malavi, Mozambiku, Nigeria, Somalia, Sudani, Zambia dhe Zimbabve.
- Rastet e kolerës kanë vazhduar të raportohen në pjesët perëndimore, lindore dhe jugore të Afrikës, disa pjesë të Lindjes së Mesme, Azisë Juglindore dhe Amerikës gjatë muajve të fundit. Rreziku i infeksionit nga kolera tek udhëtarët që vizitojnë këto vende mbetet i ulët, edhe pse importimi sporadik i rasteve në BE/EEA mbetet i mundur.

Ngjarje kombëtare

3. *Vatër Bruceloze në gjedhë, Mashkullorë, Gjirokastër*

Pas njoftimit nga Agjencia Kombëtare e ushqimit për ngarkesë mikrobike në qumështin e një ferme në fshatin Mashkullorë në Gjirokastër, shërbimi i epidemiologjisë në Njësinë vendore të kujdesit shëndetësor lajmëron shërbimin e veterinarisë dhe kryen një hetim në vatër në lidhje me situatën.

Pas testimit laboratorik të mostrave të marra nga kafshët pranë ISUV në Tiranë rezultoi se dy kafshë (lopë) ishin pozitiv me Brucella.

U lajmërua mjeku i zonës i cili konfirmon se nuk ka patur raste me shenja të brucelozës në familjen e kafshëve të prekura apo në zonën përreth. Gjithashtu u la rekomandim që qumështi të zihej para konsumimit të tij.

Situata është në monitorim të vazhdueshëm.